



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

---

**C.nr.503/10**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, si gjykatë e shkallës së parë, gjyqtari Shaban Shala, me bashkëpunëtorin profesional Malsor Kryeziu, në kontestin e paditësit A. M., nga Prizreni, rr. ..., nr. ..., të cilën me autorizim e përfaqëson Av. V. O., nga Prizreni, kundër të paditurës F. /K., dega në Prizren, rr. ..., p.n, të cilën e përfaqëson i autorizuari V. R., me objekt të padisë kompensimin e pagës, vlera e kontestit 1250 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me dt.29.04.2014 morri këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit A. M., nga Prizreni.

**II. OBLIGOHET** e paditura F. /K., që të bëjë pagesën e pagës për muajin Maj të vitit 2010, në shumën prej 1250 €, ndaj paditësit A. M., me kamatë ligjore që paguajnë bankat e vendit për depozitim mbi një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e parashtrimit të padisë 07.07.2010 e deri të pagesa definitive e pagës.

**III.OBLIGOHET** e paditura që ti bart shpenzimet procedurale, ndërsa paditësit t'ia kompensoj shumën prej 530€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

## Arsyetim

I autorizuari i paditësit Av. V. O., nga Prizreni gjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë si dhe pranë deklarimeve nga seanca përgatitore. Ndërsa në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim ka deklaruar se me administrimin e provave është vërtetuar se paditësi është punësuar te e paditura me dt.02.02.2009, me kontratë për periudhë të pacaktuar kohore. Paditësi ka punuar te e paditura deri me dt.30.05.2010, ky fakt është vërtetuar nga dëshmia e dëshmitarëve në procedurë, ku paditësi i ka kryer të gjitha detyrat e punës, i cili fakt nuk kontestohet edhe nga e paditura. Mos pagesa e pagës për muajin maj 2010 me arsyetim të mosrespektimit të kontratës së punës lidhur me afatin dyjavor të paralajmërimit për shkëputjen e njëanshme të marrëdhënies së punës është joligjore dhe në kundërshtim me Ligjin e punës 03/L-212. Neni 72 par.4 i këtij Ligji e ka rregulluar çështjen e kompensimit të pagës, ku parashihet se punëdhënësi obligohet që të bëjë pagesën e pagës dhe të ardhurave të tjera deri në ditën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Duke pasur parasysh se paditësi ka punuar deri në ditën e fundit të muajit maj 2010, e cila datë edhe nga e paditura është konsideruar si datë e fundit, e njëjta është e obliguar që të bëjë pagesën e pagës. Kjo dispozitë e Ligjit nuk parasheh ndonjë kusht me të cilin është paraparë mos pagesa e pagës për shkak të mos respektimit të kësaj dispozite. Përpos kësaj paditësi ka shpreh gatishmëri që të punojë edhe pesë ditë të tjera që të përmbush dispozitën e kontratës, mirëpo nuk është pajtuar e paditura. Lidhur me pretendimet e të autorizuarit të paditurës se padia është dorëzuar jashtë afatit ligjor, është i pabazuar. E paditura konform Ligjit të Punës ka qenë e obliguar që të merr vendim me shkrim lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës me paditësin me ç'rast do të dihej saktë dita e fundit e punës, dita e dorëzimit të vendimit paditësit, këshilla juridike. Një vendim i tillë për shkelje të detyrave të punës është dashur të merret nga ana e organit kompetent të punëdhënësit, duke respektuar me përpikëri procedurën përkatëse disiplinore. Nga provat e administruara u vërtetua se e paditura nuk ka nxjerr vendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, e aq më pak ti jetë dorëzuar paditësit. Nuk mund të llogaritet afati kur nuk kemi një vendim të tillë, ndaj të cilit lejohet ankesa e pastaj llogariten afatet, kjo sipas nenit 78 të Ligjit të punës. E paditura nuk ka nxjerr vendim dhe ka shkelur dispozitat e Ligjit të Punës nenin 72 dhe 86. Nga e gjithë kjo u vërtetua se e paditura nuk ka udhëhequr me procedurën disiplinore ndaj paditësit, dhe nuk ka marrë vendim të veçantë. Duke marrë parasysh këto shkelje i propozon gjykatës që të merr aktgjykim me të cilin aprovohet kërkesëpadia e paditësit A. M., nga Prizreni, Obligohet e paditura F. nga Prizreni, që të bëjë pagesën e pagës për muajin maj 2010 në shumën prej 1250 € (njëmijë e dyqind e pesëdhjetë) ndaj paditësit, duke llogaritur kamatën ligjore nga dorëzimi i padisë deri në ditën e përbarimit të kësaj shume, si dhe të bëjë kompensimin e shpenzimeve procedurale sipas tarifës së OAK-së dhe atë për përpilimin e padisë shumën prej 104 €, për përfaqësim në 3 seanca gjyqësore dhe atë për një seancë shumën prej 135.20 €, për tri seanca shumën totale 405.60 euro, për taksën gjyqësore shumën prej 21 €, në shumë të përgjithshme prej 530,60 €.

I autorizuari i të paditurës V. R., në shqyrtimin kryesor ka deklaruar mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi dhe deklarimit nga seanca e shqyrtimit përgatitor me theks të veçantë se padia është pa afatshme për shkak se është parashtruar pas afatit ligjor. Ndërsa në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim, ka deklaruar se me administrimin e provave u vërtetua se padia e paditësit është e palejuar pasi që është parashtruar pas afatit ligjor, në kuptim të nenit 391 par. f i LPK-së. Paditësi ka dhënë dorëheqje me dt.25.05.2010, ndërsa është njoftuar të nesërmen me dt.26.05.2010 se nuk do ti paguhet paga për muajin maj 2010. Paditësi ka parashtruar padi në gjykatë me dt.07 korrik 2010 që do të thotë pas 42 dite, deri sa afati i paraparë sipas nenit 79 të Ligjit të punës është 30 ditë. Gjithashtu paditësi paraprakisht inicimit të rastit në gjykatë është dashur të paraqesë kërkesë të punëdhënësi për realizimin e të drejtave të shkelura, gjë të cilën nuk e ka bërë. Po ashtu nga provat e administruara u vërtetua se padia e paditësit është e pabazuar pasi që paditësi i ka shkelur obligimet e tij kontraktuale të cilat i ka pranuar dhe i ka nënshkruar. Neni 5 i kontratës parasheh që i punësuari mund të ndërpresë kontratën e punës me njoftim paraprak me shkrim prej 2 javësh, ndërsa paditësi me 25 maj 2010 ka paralajmëruar se me 30 maj do të ndërpresë këtë kontratë duke i dhënë punëdhënësit një njoftim prej vetëm 5 ditëve. Pacta sun servanda – obligimet janë ligj për palët andaj paditësi nuk i ka respektuar obligimet e tij, tani nuk është e qartë pse i njëjti paraqet padi. Punëdhënësi me plotë të drejtë ka vendosur që për dëmin e shkaktuar nga shkelja e obligimeve kontraktuale të kërkoj nga i punësuari dëmshpërblim duke i ndalur pagën për atë muaj. Pëveç kësaj dëshmia e mbikëqyrësit të paditësit Menaxherit të Departamentit të Auditimit të Brendshëm – M. K., të cilin pala paditëse e ka propozuar vet si dëshmitar, u dëgjua se i punësuari është kërcënuar me shkrim punëdhënësit se në rast mos pagesës së pagës, ai do të lëshon në qarkullim informata konfidenciale dhe sensitive për punëdhënësin të cilat i ka mësuar gjatë punës tek e paditura. Në këto rrethana e paditura nuk ka mundur ta shpërblen të punësuarin andaj edhe vendimi ka qenë i drejtë. Kërkojmë nga Gjykata Themelore në Prizren, pas administrimit të provave të merr aktvendim me të cilin hedhet poshtë padia e paditësit si e palejuar meqenëse është paraqitur pas afatit ligjor ose të merr aktgjykim me të cilin kërkesëpadia e paditësit A. M. të refuzohet si e pathemeltë. Shpenzimet procedurale i kërkoj dhe atë sipas tarifës së OAK-së për secilën nga tri seancat e mbajtura 135 € përkatësisht 405 € dhe kompensimin e taksave gjyqësore aq sa janë ato.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat: ka bërë dëgjimin e paditësit A. M. në cilësinë e palës, dëgjimin e dëshmitarit B. G., dëgjimin e dëshmitarit M. K., leximin e kontratës së punës të dt.26.05.2009, leximin e e-mailit të dt.25.05.2010, leximin e e-mailit të dt.26.05.2010 ora 10:45, të dt.26.05.2010 ora 13:48, të dt.26.05.2010 ora 14:58, të dt.26.05.2010 ora 15:11, të dt.27.05.2010 ora 9:06, të dt.28.05.2010 ora 10:37.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura në kuptim të nenit 8 të Ligjit Për Procedurën Kontestimore (LPK), duke analizuar me kujdes dhe me ndërgjegje çdo provë veç e veç dhe të gjitha atë së bashku dhe ka konstatuar se:

Kërkesëpadia e paditësit është **e bazuar.**

Gjykata nga dëgjimi i paditësit A. M., në cilësinë e palës i cili ka deklaruar: se ka filluar punën në F. në janar 2009 dhe deri me 30 maj 2010, ka punuar në pozitën e zyrtarit të lartë të auditimit të brendshëm. Me dt.20.05.2010, e ka njoftuar me e-mail përgjegjësin F. dhe e ka paralajmëruar se me dt.30.05.2010 do ta përfundojë marrëdhënien e punës me F. me arsye të punësimit diku tjetër. Nga Drejtoresha gjenerale e F. ka marrë e-mailin me të cilin e njofton se për shkak të mos përmbushjes së kushtit të kontratës për njoftim 2 javë para kohe nuk do të marrë pagën e muajit maj 2010, pas disa e-mailave që ka shkëmbyer e ka lutur që ta rishikojnë vendimin me qëllim që të paguhet paga e muajit maj 2010 dhe u ka ofruar që të punoj edhe 2 javë pas njoftimit për ndërprerjen e kontratës. Ata kanë pranuar që të punoj deri në fund të muajit, por pa kompensim të pagës. I njëjti po ashtu në pyetjen e gjykatës ka deklaruar se ka punuar deri në fund të muajit maj 2010 në cilësinë e Zyrtarit të Lartë të Auditimit të Brendshëm, ku ato ditë ka qenë në auditim të degës së F. në Prizren, kurse sa i përket evidentimit për hyrje në zyrën qendrore në Prishtinë është mbajtur evidenca, mirëpo kjo nuk ka vlejtur për auditorët për shkak të punës së ndjeshme dhe specifikave të punës në teren. Po ashtu në pyetjen e të autorizuarit të tij paditësi është përgjigjur se mbikëqyrës i tij ka qenë M. K., të cilit e ka raportuar i cili ka qenë Menaxher i Auditimit të Brendshëm, ndërsa vendim me shkrim për shkaputjen e kontratës së punës nuk ka marr, ndërsa në pyetjen e të autorizuarit të paditurës i njëjti është përgjigjur se me dt.25.05.2010 ka paraqitur dorëheqjen nëpërmjet e-mailit duke i njoftuar ata se nga data 01.06.2010, do të ndërpresë marrëdhënien e punës, ndërsa në lidhje me shpërndarjen e informatave konfidenciale të punëdhënësit një gjë të tillë nuk i kujtohet se e ka thënë nëse nuk i paguhet paga kontestuese. Nga kjo deklaratë gjykata u njoftua lidhur me krijimin e marrëdhënies së punës, mënyrën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës dhe shkaqet të cilat sollën deri te përfundimi i saj, si dhe për mos pagesën e pagës për muajin maj 2010, po ashtu edhe për komunikimin ndërmjet paditësit dhe të paditurës lidhur me këtë çështje juridike.

Me dëgjimin e dëshmitarit B. G., i cili ka deklaruar : se gjatë periudhës kontestuese ka punuar në cilësinë e administratorit të burimeve njerëzore njëkohësisht koordinator i trajnimeve, ku ka punuar deri në muajin maj të vitit 2013. Ai në këtë paditësi ka paraqitur dorëheqjen në mënyrë elektronike data e saktë nuk i kujtohet, po ashtu është paraqitur edhe personalisht, detyra e dëshmitarit ka qenë që me i procesuar çështjet tek menaxhmenti i cili ka marrë vendim që paga e fundit e muajit maj 2010 të mos paguhet për shkak se paditësi nuk e ka zbatuar afatin e caktuar me kontratë. Mirëpo paditësi ka punuar deri në fund të muajit maj të vitit 2010. Po ashtu

ka deklaruar se në rastin në fjalë nuk kanë lëshuar vendim të veçantë për ndalimin e pagës dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës, për shkak se kemi të bëjmë me dorëheqje të paditësit. Nga kjo deklaratë gjykata u njoftua me mënyrën e paraqitjes së dorëheqjes së paditësit dhe vërtetoi faktin se paditësi të e paditura ka punuar deri në fund të muajit maj 2010 dhe për këtë muaj paditësit nuk i është paguar paga dhe ky ndalim është bërë pa u marr kurrfarë vendimi nga e paditura.

Me dëgjimin e dëshmitarit M K , punëtor i të paditurës-Udhëheqës i Departamentit të Auditimit të Brendshëm, i cili ka deklaruar: se paditësin e ka pasur koleg me eksperiencë në fushën e auditimiti cili ka filluar punën në vitin 2009 tek e paditura. Po ashtu vërtetohet se paditësi ka punuar te e paditura deri me dt.31.05. 2010, deri diku rreth orës 14:00 pasdite dhe i revoltuar e ka lëshuar zyrën, për arsye të mos pagesës së pagës të muajit maj të vitit 2010 ku paditësi 5 ditë para përfundimit të muajit ka paraqitur dorëheqjen, ndërsa sa i përket rregullave të brendshme të paditurës dhe kontratës së punës njoftimi për dorëheqje duhet të bëhet 10 ditë para ndërprerjes së marrëdhënies së punës dhe si pasojë e kësaj menaxhmenti i të paditurës i ka ndaluar pagën e muajit maj 2010. Po ashtu është fakt që paditësi ka kërkuar nga bordi i të paditurës që të plotësohet ky afat duke u ofruar atyre që të punoj deri me datën e caktuar që të përmbushet ky afat 10 ditor, mirëpo bordi e ka refuzuar. Po ashtu i njëjti është përgjigjur se e paditura i ka ngritur mekanizmat për zhvillimin e procedurave disiplinore në bazë të akteve të brendshme normative, ndërsa sa i përket këtu paditësit përgjigjet se nuk posedon ndonjë vendim me të cilin është zhvilluar ndonjë procedurë disiplinore ndaj paditësit ku në bazë të cilës i është shqiptuar ndonjë masë disiplinore duke përfshirë edhe ndalesën e pagës kontestuese. Po ashtu ka deklaruar se paditësi i ka përmbushur të gjitha detyrimet nga kontrata e punës deri me dt.31.05.2010. Po ashtu është përgjigjur se ka pasur një e-mail ku paditësi ka paralajmëruar se nëse nuk i bëhet pagesa e pagës së muajit maj 2010 do ti plasoj në opinion materiale sensitive-konfidenciale të paditurës, pas këtij e-maili nuk ka njohuri se diçka e tillë ka ndodhur nga ana e paditësit. Nga kjo deklaratë gjykata u njoftua me historianin e të punësuarit këtu paditësit dhe vërtetoi faktet si në vazhdim se paditësi ka njoftuar paraprakisht të paditurën për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, për profesionalizmin e treguar në punë nga paditësi, për mos zhvillimin e procedurës disiplinore kundër paditësit dhe faktin se paditësi ka kryer detyrat e punës deri më 31.05.2010 ku në ora 14:00 të kësaj date e ka lëshuar punën i indinjuar për mospagesën e pagës.

Me leximin e kontratës së punës të dt.26.05.2009, gjykata konstatoi se paditësi me të paditurën kanë lidhur kontratë punësimi në afat të pacaktuar, e cila kontratë ka qenë efektive prej dt.02.02.2009 ku 90 ditët e para të kontratës janë konsideruar si punë provuese. Paditësi ka qenë i punësuar si Auditor Senior i Mbrendshëm. Pageşa e pagës mujore sipas kontratës ka qenë 1250 €. Sipas kontratës punëtori me vetë dëshirë mund ta ndërpret kontratën me njoftim paraprakë me shkrim prej 2 javësh. Në kontratë nuk është paraparë se në rast të mos njoftimit për ndërprerje të kontratës nga punëtori atij të mund ti shqiptohet ndonjë masë sikurse ndalesa e pagës.

Me leximin e e-mailit të dt.25.05.2010, leximin e e-mailit të dt.26.05.2010 ora 10:45, të dt.26.05.2010 ora 13:48, të dt.26.05.2010 ora 14:58, të dt.26.05.2010 ora 15:11, të dt.27.05.2010 ora 9:06, të dt.28.05.2010 ora 10:37, gjykata ka konstatuar se paditësi me dt.25.05.2010, e ka njoftuar të paditurën se nga data 1 qershor e ndërpre në marrëdhënien e punës, për arsye personale. Ndërsa me dt.26.05.2010, e paditura i përgjigjet se për shkak të mos respektimit të afatit dy javor për dorëheqje do të ndërpritet paga për muajin maj si masë ndëshkuese. Po ashtu me të njëjtën datë paditësi komunikon me të paditurën ku kërkon që të vazhdojë të punojë edhe një javë me qëllim që të plotësohet afati prej dy javëve, dhe kërkon që ti paguhet paga e cila i takon, ku edhe e njofton se është duke punuar dhe i angazhuar në punën në teren duke i përmbushur absolutisht të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë që kërkojnë nga SIA. E paditura refuzon kërkesën e paditësit, por i lënë mundësinë që edhe njëherë menaxhmenti të diskutojë këtë çështje dhe do të vendos përfundimisht nëse do të pranojë ofertën e paditësit. Komunikimi ka vazhduar ende përmes e-mailit me dt.28.05.2010, ku paditësi njoftohet nga e paditura se nuk e pranon ofertën për të vazhduar shërbimet e tij edhe për një javë pas datës së përcaktuar për dorëheqje.

Në rastin konkret në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar të vërtetuar më lartë, gjykata e ka aprovuar në tërësi kërkesë-padinë e paditësit sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Sipas bindjes së kësaj gjykate pretendimet e palës paditëse janë të bazuara pasi që në tërësi u vërtetua se paditësi ka qenë i punësuar të e paditura në cilësinë e Auditorit Senior të Brendshëm që nga dt.02.02.2009, ku 90 ditët e para të kontratës janë konsideruar si punë provuese. Paditësi ka punuar te e paditura deri në fund të muajit maj 2010 respektivisht deri me dt.31.05.2010, ku e ka përmbushur në tërësi kontratën e punës respektivisht muajin maj (kontestues). Gjithashtu është fakt i pamohueshëm se paditësi deri në përfundim të muajit ka qenë në punë dhe i ka kryer me sukses punët dhe detyrat e punës pa pasur asnjë vërejtje nga ana e menaxhmentit të cilat fakte vërtetohen nga deklarami i paditësit dhe nga deklarami i dëshmitarëve B. G. dhe M. K. të cilave prova gjykata plotësisht ia fali besimin pasi që janë në harmoni dhe e plotësojnë njëra-tjetrën. Po ashtu nga shkresat e lëndës dhe nga deklaratat e dëshmitarëve del se paditësi e ka përmbushur obligimin e tij nga kontrata duke i ofruar të paditurës që të punojë edhe një javë deri në përmbushjen e afatit të paraparë në kontratë, gjë të cilën e paditura e ka refuzuar. Nga gjendja faktike e vërtetuar nuk del se ndaj paditësit është zhvilluar ndonjë procedurë disiplinore dhe si pasojë ti jetë ndaluar paga për muajin maj të vitit 2010. Sa i përket pretendimit të paditurës se padia është parashtruar pas afatit ligjor, kjo nuk qëndron pasi që fillimisht e paditura nuk ka zhvilluar procedurë disiplinore ndaj paditësit, ku si pasojë do të shqiptohej masa disiplinore-ndalesa e pagës për muajin maj të vitit 2010 dhe vetëm pas nxjerrjes së vendimit dhe dorëzimit të tij paditësit do të vinte në shprehje llogaritja e afatit për parashtrimin e padisë. Pretendimi i të paditurës se paditësi nuk e ka përmbushur kontratën respektivisht lajmërimin 2 javor para përfundimit të marrëdhënies së punës qëndron, mirëpo në kontratë nuk parashihet me asnjë nen se në rast se i punësuar nuk e lajmëron në afat prej 2 javësh punëdhënësin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës ndaj tij do të merren masa disiplinore me ndaljen e pagës.

Duke e pasur për bazë këtë gjendje faktike dhe duke u bazuar në dispozitat e kontratës së punës ndërmjet palëve kontestuese të datës 26.05.2009 nga e cila rrjedh se obligimi i të paditurës për kryerjen e detyrave të punës në baza mujore për paditësin ka qenë 1250 € dhe faktin e vërtetuar nga gjykata se paditësi për muajin kontestues maj të vitit 2010 ka përmbushur obligimet nga kontrata, ndërsa kompensimin në pagë nuk e ka marr vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke u bazuar në dispozitat e kontratës e të cilat bazohen në nenin 9 të Rregullores së UNMIK-ut nr.2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë i cili ka qenë në fuqi në kohën kur është paraqitur kjo çështje kontestuese, pra muaji maj i vitit 2010 dhe se Ligji 03 L-212 i Punës i Kosovës ka hyrë në fuqi pasi që kjo çështje kontestuese ka lindur.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale bazohet në nenit 452.1 të LPK-së pasi që e paditura ka humbur kontestin, ndërsa llogaritja e tyre bazohet në tarifën e Odës së Avokatëve dhe atë për përfaqësimin e avokatit shumë prej 405.60 € për tri shqyrtime të mbajtura nga 135 €, për përpilim të padisë 104 € dhe për taksën për padi 21 €.

Nga të lartcekurat dhe bazuar në nenin 55 të Ligjit të punës Ligji Nr.03/L-212, lidhur me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.


**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**C.nr.503/10, datë 29.04.2014**

**Bashkëpunëtori profesional,**  
**Malsor Kryeziu**



**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.

**Gjyqtari,**  
**Shaban Shala**



Exp: 2 aktgjykime  
2 shk. dërgese  
03.07.2014